



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Në pajtim me nenin 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 17 paragr. 2 nënparagr. 2.3 të Rregullores (QRK) për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kryetari i Komunës me datën shpall këtë:

THIRRJE PUBLIKE

Për anëtar të komisionit vlerësues për vlerësim të ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

Qëllimi i thirrjes:

Propozimi për Kuvend të komunës i një anëtari nga shoqëria civile në komisionin vlerësues për vlerësim të ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe Rregullores (QRK) për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Propozimi:

Çdo OJQ e komunës e regjistruar në Ministrinë përkatëse të Republikës së Kosovës, që është aktive në tri vitet e fundit në Komunën e Vushtrrisë propozon një anëtar nga OJQ e njejtë i cili do të mund të zgjidhet në përbërje të komisionit vlerësues për vlerësim të ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Kriteret për propozim:

Kandidati i propozuar duhet të posedoj përgatitje superiore profesionale (Bachelor ose Master). Prioritet, njohuri në menagjimin/vlerësimin e pronës së paluajtshme.

Në raste paraqitjes së dy e ma tepër propozimeve, përzgjedhja do të bëhet nga komisioni i cili do të formohet me vendim.

Afati për propozime:

Afati për paraqitjen e propozimeve është deri me datën 30.01.2026

Dokumentet e kërkuara:

- CV. e kandidatit të propozuar
- Diploma
- Certifikatë e vendbanimit
- Kopje e Letërnjoftimit

Dorëzimi i propozimit duhet bëhet në zyrën pritëse të komunës së Vushtrrisë, sheshi “Ahmet Krasniqi” Nr. 10, adresuar për Kryetarin e komunës.

Propozimet e arritura pas datës 30.01.2026 nuk do të merren në konsideratë.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

